



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.146/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada-Gllogjani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, dukë vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës BIRN dhe Inter News Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 02.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** ankesa e Organizatës BIRN dhe Inter News Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 2,700,00 euro (dymijë e shtatqind), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përbarimit.

### A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe Inter News Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 30.09.2019, me të cilën pretendon se kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës në një tubim me qytetarët e qytetit të Lipjanit, është parë me një vajze të mitur duke marrë dhuratë një tufë me lule, të cilën më pas e rrit në skenë dhe e mbanë në krahë. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë Kadri Veseli, kandidat për Kryeministër nga radhët e subjektit politik PDK, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të datës 01.10.2019, theksoi se lidhur me ankesën Anr.146/2019 me të cilën iu ka bashkangjitur ankesës, dhurimi i një buqete me lule nga një fëmijë i mitur nuk përmban shkelje të Rregullores Zgjedhore nr. 20/2019, neni 2.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre nuk i kanë bashkëngjitur asnjë provë si dëshmi se me të vërtetë bëhet fjalë për një të mitur e cila supozohet të jetë në prezencë të prindërve.

Subjekti politik PDK kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga BIRN dhe IKS të hudhet e pazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotoja e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Kadri Veseli, nga radhët e subjektit politik

PDK, ka përdorur një fëmijë të mitur në një tubim në fushatë zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore nr. 20/2019, neni 5 pika 5.2 e Riformular pika h), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së, e cila thotë: “personat të cilët nuk i kanë mbushur 18 vjet në Ditën Zgjedhore, përveç kur janë të shoqëruar nga prindërit e tyre apo me pëlqimin e prindërve”

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik PDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t’u përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre, nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar, me arsyetimin se fëmija që shihet në fotografi të cilën e ka bartur kandidati për kryeministër i subjektit politik PDK, me siguri se ka qenë në prezencën e prindërve.

PZAP mori parasysh pretendimet e tilla, po që ishin pa ndikim në vendosje ndryshe të çështjes. Me këtë vendim dhe shqiptim të gjobës paneli vendosi se do të ndikon te subjekti politik që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 146/2019 më datën 02.10.2019

**Kryesuesja e Panelit**  
Afijete Sada-Gllogjani



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***